



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr:230

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E PËRKTHYESVE TË MISIONIT TË ENEMO PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021.

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Të miratojë kërkesën e Misionit të ENEMO-s për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së
3. Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI**

